

KODEKS PËR TRAJTIM TË FURNIZIMEVE PUBLIKE

Фонд за осигурување на депозити
Fondi për sigurimin e depozitave
02-211
02.01.2026 год.
Скопје / Shkup

1. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me kodeks për trajtim të furnizimeve publike (në tekstin e mëtejme: Kodeks) rregullohen parimet themelore, mënyra dhe rregullat e sjelljes së personave që kryejnë punë në fushën e furnizimit publik, kryetarit dhe anëtarët e komisionit të prokurimit publik, përgjegjësitë dhe standardet etike në planifikimin, zbatimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit publik në Fondin e Sigurimit të Depozitave (në tekstin e mëtejme: Fondi).

Neni 2

Ky Kodeks është miratuar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe rregulloret e tjera në fushën e operacioneve financiare, parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Neni 3

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen për të gjithë punonjësit, personat përgjegjës, anëtarët e komisioneve të prokurimit publik, personat udhëheqës dhe personat e tjerë që në çfarëdo mënyre marrin pjesë në procesin e prokurimit publik në Fond.

Të gjitha procedurat e prokurimit publik kryhen ekskluzivisht për qëllimin e kryerjes së punës dhe aktiviteteve të Fondit, si institucion financiar i specializuar që është në pronësi të shtetit.

2. PARIMET PËR ZBATIMIN E PROKURIMIT PUBLIK

Neni 4

Gjatë zbatimit të prokurimit publik në Fond, personat që zbatojnë procedurat e prokurimit publik janë të detyruar të respektojnë parimet e mëposhtme:

- ligjshmëria dhe përputhshmëria me rregulloret;
- ekonomi, efikasitet dhe efektivitet;
- trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i operatorëve ekonomikë;
- transparencë dhe publicitet;
- konkurrencë dhe proporcionalitet;
- llogaridhënie dhe integritet.

**3. RREGULLAT E SJELLES DHE INTEGRITETIT****Neni 5**

Personat duhet t'i kryejnë prokurime publike në Fond, në përputhje me ligjin, pa diskriminim, preferenca dhe pa asnjë interes personal, në nivel të lartë profesional, të cilin duhet ta përmirësojnë vazhdimisht dhe ta zhvillojnë vazhdimisht veten në fushën e prokurimeve publike.

Personat, kur kryejnë prokurime publike, duhet të shmangin çdo lloj sjelljeje joetike, dhe ata që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me personat fizikë dhe persona juridikë duhet të sillen me përgjegjësi, kujdes, edukatë dhe informacionin t'a paraqesin në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, t'u përgjigjen pyetjeve të bëra dhe të referojnë aty ku është e nevojshme për të ushtruar të drejtat dhe interesat e tyre. Personat duhet të kryejnë çdo komunikim dhe shkëmbim informacioni me persona fizikë dhe persona juridikë duke përdorur mjete elektronike, përmes Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik, përveç kur është e nevojshme të përdoret një metodë tjetër komunikimi.

Gjatë zbatimit të prokurimeve publike, personat që zbatojnë prokurimet duhet të përmbushin detyrimet për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin.

Neni 6

Gjatë zbatimit të prokurimeve publike, personat duhet të përmbushin parimet dhe rregulloret për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shmangin veprimet ose mosveprimet që bien ndesh me rregulloret ligjore që mund të jenë shkak i shkeljes së integritetit të tyre personal, duhet të veprojnë me përgjegjësi dhe duhet të përdorin të dhënat dhe informacionin e marrë gjatë zbatimit të prokurimit publik vetëm për zbatimin e prokurimit publik specifik.

Neni 7

Personat e përfshirë në prokurimin publik duhet të veprojnë profesionalisht, në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme, pa u ndikuar nga interesa personale, financiare ose të tjera.

Neni 8

Ndalohet kërkesa, pranimi ose dhënia e dhuratave, shërbimeve ose çdo përfitimi tjetër që mund të ndikojë ose të krijojë përshtypjen e ndikimit në vendimmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Neni 9

Çdo person i përfshirë në ë procedurë prokurimi publik është i detyruar të shmangë konflikt interesi dhe të raportojë menjëherë çdo konflikt interesi të mundshëm ose aktual, në përputhje me rregulloret ligjore.



4. PLANIFIKIMI I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 10

Prokurimi publik planifikohet në bazë të nevojave reale, burimeve financiare të miratuara dhe objektivave strategjike të Fondit.

Neni 11

Plani vjetor i prokurimit publik përgatitet dhe miratohet në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe publikohet në mënyrën dhe brenda një periudhe të përcaktuar me ligj.

5. ZBATIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Neni 11

Procedurat e prokurimit publik zbatohen në përputhje me llojin dhe vlerën e prokurimit, në përputhje të plotë me procedurat e përcaktuara me ligj.

Neni 12

Specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë të qarta, jo-diskriminuese dhe të lidhura me lëndën e prokurimit.

Neni 13

Komisionet e prokurimit publik veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të përgjegjshme, dhe janë të detyruara të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

6. NEGOCIMI DHE ZBATIMI I KONTRATAVE

Neni 14

Kontratat e prokurimit publik lidhen me shkrim dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në procedurën e prokurimit publik.

Neni 15

Zbatimi i kontratave do të monitorohet vazhdimisht, me qëllim identifikimin e menjëhershëm të çdo parregullsie, vonese ose devijimi.

7. TRANSPARENCA DHE DOKUMENTACIONI

Neni 16

Të gjitha aktivitetet që lidhen me prokurimin publik duhet të dokumentohen dhe arkivohen në mënyrë të përshtatshme në përputhje me rregulloret në fuqi.

Fondi siguron transparencë duke publikuar informacion mbi prokurimin publik në përputhje me detyrimet ligjore.

8. MBIKËQYRJA DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 18

Mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij Kodeksi kryhet nga njësitë organizative kompetente dhe personeli drejtues në Fond.

Neni 19

Mosrespektimi i dispozitave të këtij Kodi përbën shkelje të detyrimeve të punës dhe mund të rezultojë në përgjegjësi disiplinore, kundërvajtjeje ose përgjegjësi të tjera, në përputhje me ligjin.

9. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe zbatohet nga dita e publikimit të tij në tabelën e njoftimeve në Fond.

Neni 21

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Kodeksi bëhen në të njëjtën mënyrë si miratimi i tij.

Drejtor
Behar Emini



Përkethimi: Luljeta Azizi

